



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:070450

Datë: 26.12.2023

Numri i dokumentit: 05120918

C.nr.1529/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M. K. nga Fushë Kosova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokate L. B. Y. nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Fushë Kosovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e ushqimit në punë (shujtave), jashtë seancës, me datë 26.12.2023 mori këtë:

AKTGJYKIM

Për shkak të padëgjueshmërisë

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M. K. nga Fushë Kosova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Fushë Kosovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit në punë (shujtave) për 352 ditë pune, nga data 01.04.2018 e deri me datë 13.09.2020, t’ia paguajë shumën prej 704.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 15.04.2021 kur është parashtruar padia, e deri në pagesën definitive, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 124.00 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Arsyetimi

Paditësja M. K. , përmes të autorizuarës së saj, me datë 15.04.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën e ushqimit gjatë punës, me kamatë ligjore.

Paditësja padinë e saj e ka ndryshuar në aspektin objektiv me parashtrësën e datës 01.12.2023.

Në padi dhe në parashtrësën për ndryshimin e padisë ka theksuar se ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, në ShFMU ,Komuna e Fushë Kosovës. Më tutje ka shtuar se paditëses në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit i takon shpërblimi për ushqim gjatë punës nga 2 euro për çdo ditë pune, përkatësisht për 352 ditë pune për periudhën 01.04.2018 – 13.09.2020 në vlerë prej 704.00 euro.

Shpenzimet i ka kërkuar, dhe atë 104 euro për përpilimin e padisë dhe 20 euro për taksë gjyqësore.

E paditura, me datë 27.09.2022 e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat, dhe me datë 05.12.2023 e ka pranuar parashtresën për ndryshimin e padisë të datës 01.12.2023, por fare nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, parashtresës për ndryshimin e padisë si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 150 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) gjeti se plotësohen të gjitha kushtet për marrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë, andaj, pa caktuar seancë fare, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Neni 150.1 i LPK-së, parasheh se *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykim për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht”*.

Sa i përket kushtit të parë të cekur më lart, gjykata nga shkresat e lëndës, konstaton se e paditura e ka pranuar me rregull edhe aktvendimin për përgjigje në padi, bashkë me padinë dhe provat tjera, edhe parashtresën për ndryshimin e padisë, dhe ka qenë e njoftuar me aktvendimin për përgjigje në padi, që nëse e paditura nuk përgjigjet në padi dhe gjykata vlerëson se plotësohen kushtet ligjore, do të marrë aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë, por, megjithatë, e paditura nuk është përgjigjur në padi.

Sa i përket gjendjes faktike, nga Kontrata e punës për mësimdhënës, e datës 01.09.2015, me nr. të protokollit 317 gjykata vërtetoi fakti se paditësja ishte në marrëdhënie pune tek e paditura, në vendin e punës *“Mësimdhënëse e mësimi klasor”* në ShFMU, Komuna e Fushë Kosovës.

Nga vërtetimi me nr. 303/2023, i datës 24.11.2023, i lëshuar nga ShFMU, Komuna e Fushë Kosovës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja, për periudhën nga data 01.04.2018 e deri me datë 13.09.2020 ka qenë e pranishme në punë për 352 ditë pune.

Gjykata vlerësoi edhe provat tjera në shkresat e lëndës, por të njëjtat ishin të parëndësishme për të vendosur ndryshe.

Në rastin konkret lidhur me kushtin e dytë që ka të bëjë me themelësinë e kërkesëpadisë, gjykata zbatoi Kontratën Kolektive e Arsimit në Kosovë (KKAK) e miratuar dhe e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) me datën 18.04.2017, e cila ka qenë e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj, e deri me datë 21.01.2021, dhe kështu, në

ndërlidhje me gjendjen faktike të vërtetuar si më lart, vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë.

Neni 2, paragrafi 1 i KKAK-së përcakton se: *“Dispozitat e Kontratës Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit para universitare (parashkollor, filllore, të mesme të ultë, të mesme të lartë, shkolla speciale dhe qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, [...]”* Ndërsa, paragrafi 2 i të njëjtit nen përcakton se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat – DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in, etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës*

Po ashtu, me nenin 35, paragrafi 7 të KKAK-së, parashihet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditës e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore. [...]”*

Në rastin në fjalë gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim t’ia paguajë paditësit kompensimin për ushqimin gjatë punës. Kjo për faktin se ky detyrim është paraparë me nenin 35, paragrafi 7 i KKAK-së.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për ushqimin gjatë punës (shujtave) mori për bazë vërtetimi mbi ditët e pranisë në punë me numër nr. 303/2023, i datës 24.11.2023, i lëshuar nga ShFMU, Komuna e Fushë Kosovës, sipas të cilit vërtetim paditësi nga data 01.04.2018 e deri me datë 13.09.2020 gjithsej ka qenë e pranishme 352 ditë pune, atëherë asaj për 352 ditë pune i takojnë nga dy euro në ditë, pra gjithsej 704 euro.

Kështu, gjykata nga të gjeturat e cekura më lart e ka detyruar të paditurën që paditëses në emër të kompensimit për ushqimin gjatë punës t’ia kompensojë shumën në lartësi prej 704 euro.

Rrjedhimisht, nga gjendja faktike e lartcekur, e vërtetuar me provat e propozuara nga paditësja, gjykata konstaton se plotësohet edhe kushti i tretë për marrjen e këtij lloji të aktgjyqimit, pasi që faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësja apo me faktet e ditura botërisht, por përkundrazi, janë në përputhje të plotë me provat e propozuara nga paditësja.

Lartësia e kamatës prej 8%, është përcaktuar në bazë të nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe e njëjta do të llogaritet në shumën e aprovuar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumën prej 124.00 €, i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104 euro, duke u bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, dhe 20 euro në emër të taksës gjyqësore.

Nga se u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.1529/21, datë 26.12.2023

Gjyqtari
Freskim Musliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.